



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:  
“Teknologji e Instalimeve Elektrike”  
“Kolegji Profesional i Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.As. Genci SHARKO**

**Dr. Fatmir BASHOLLI**

**Qershor / 2024**

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në:****“ Teknologji e Instalimeve Elektrike”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i studimit me karakter profesional ”Teknologji e Instalimeve Elektrike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr.375, datë 25.07.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 435, datë 17.12.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 17, datë 02.03.2019
8	Cikli i studimit:	Program Studimi me Karakter Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i KSHK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2020 – 2021 – 10/3 v.a. 2021 – 2022 – 9/4 v.a. 2022 – 2023 – 7/8 v.a. 2023 – 2024 – 8/6
18	Numri i studentëve:	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë: v.a. 2017 – 2018 – 11 v.a. 2018 – 2019 – 15 v.a. 2019 – 2020 – 25



		v.a. 2020 – 2021 – 9 v.a. 2021 – 2022 – 14 v.a. 2022 – 2023 – 17 v.a. 2023 – 2024 – 19
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) është institucion privat i arsimit të lartë në vend, operon sipas sistemit të Bolonjës dhe i korrespondon Nivelit 5 të Kornizës së Kualifikimeve Shqiptare. Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) përbëhet nga dy njësi bazë respektivisht:

1. Departamenti Teknologjisë së Informacionit;
2. Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara;

Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” ofrohet nga Departamenti Teknologjisë së Informacionit, Kolegji Profesional i Tiranës.

Hapja e programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është miratuar me Urdhërin e MAS nr.375, datë 25.07.2017.

Ky program studimi realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë “Profesionale” në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit të Kolegjit Profesional të Tiranës.

Studentet e regjistruar në këtë program studimi, sipas viteve janë:

Në vitin akademik 2017 – 2018 – 11 studentë, vitin akademik 2018 – 2019 – 15 studentë, vitin akademik 2019 – 2020 – 25 studentë, vitin akademik 2020 – 2021 – 9 studentë, vitin akademik 2021 – 2022 – 14 studentë, vitin akademik 2022 – 2023 – 17 studentë dhe vitin akademik 2023 – 2024 – 19 studentë.

Akreditimi i parë i programit të studimit TIE është bërë me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 17, datë 02.03.2019, “Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Shtator 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KPT për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KPT, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë. Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Dr. Genci Sharko dhe Dr. Fatmir Basholli, me mbështetjen e koordinatores së ASCAL, MSc. Anilda Beqiraj.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Tetor 2023, me dorëzimin nga ana e Kolegjit Profesional të Tiranës, Tiranë (KPT) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Rektorin e Kolegjit Profesional, Përgjegjës të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Zyres së Kurrikulës, Zyres së Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës së Studentit dhe me studentët e programit të studimit. GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, zyren e Burimeve njezore etj. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT


### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 17, datë 02.03.2019, janë:

1. Institucioni, përpara fillimit të vitit të ri akademik 2019-2020, të rekrutojë staf të ri akademik efektiv dhe me ekspertizë në fushën e teknologjisë së instalimeve elektrike, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70 %;
2. Institucioni, të shtojë në bibliotekë numrin e kopjeve fizike në funksion të këtij programi studimi;

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni


Në vijim të Vendimit të Bordit të Akreditimit, Nr. 17, datë 02/03/2019, "Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në "Teknologji e Instalimeve elektrike", KPT ka marrë hapa konkretë në lidhje me to.

1. **Në lidhje me rekomandimin 1**, KPT ka garantuar një mjedis pune të shëndetshëm që ofron mundësi të barabarta dhe jodiskriminuese për personelin akademik dhe administrativ, me politika të qarta të burimeve njerëzore të cilat synojnë tërheqjen e një stafi sa më profesionist dhe të kualifikuar. Që nga akreditimi i fundit dhe në vijim, perfshi edhe vitin akademik 2023 – 2024, në programin e studimit "Teknologji Instalime Elektrike" janë angazhuar 70% e stafit efektiv i cili mbulon lëndët bazë, lëndët karakterizuese, lëndët ndërdisiplinore dhe/ose me zgjedhje dhe lëndë plotësuese. Staf i jo efektiv mbulon 30 % të ngarkesës mësimore sipas disiplinave të mësipërme. Ndonëse aktualisht KPT për sa i përket stafit akademik është në përputhje me VKM Numër 370, datë 26.4.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë". GVJ konstaton se aktualisht nuk kemi staf të ri efektiv të rekrutuar për kategorinë me Tituj dhe Grada Shkencore. **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
2. **Në lidhje me rekomandimin 2**, Në krahasim, me periudhën e akreditimit të parë, KPT ka pasuruar bibliotekën e tij. Pjesë e gamës së bibliotekës janë ciklet e leksioneve të KPT, manualët e laboratorëve të KPT në gjuhën shqipe dhe angleze dhe botimet e stafit të KPT, përfshirë, monografi, kumtesa, artikujt, si dhe titujt që janë dhuruar nga anëtarë të stafit dhe dhurime nga të tretët etj. Ka rritur bashkëpunimin dhe ka hartuar marrëveshjeve me IAL të tjera në vend, duke siguruar akses për stafin dhe studentët në një fond të gjerë titujsh dhe në bibliotekat online të Universitetit Europian të Tiranës për një gamë prej 10 mijë titujsh fizike dhe akses në librari online



si <http://europs-services.ubt-uni.eu/login.php> . Kolegji Profesional i Tiranës ofron bibliotekën e hapur për studentët, pedagoget dhe stafin mbështetes dhe ka krijuar <https://kolegjiprofesional.edu.al/libraria-online> (Open Educational Resources (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore.Linku gjendet ne faqen e internetit te KPT, seksioni “Shërbimet”. **Ky rekomendim është përmbushur plotësisht.**

Më datë 28/05/2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 164/7 Prot. datë 28/05/2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.  
Kolegji ktheu përgjigje përmes AMS, më datë 29/05/2024. dhe shkrese Nr prot 244/1 date 29.05.2024 Komente nuk ka, Drafti kalon ne Raport perfundimtar.





## **Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”**

### **I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ vlerëson se programi i studimit në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjike cilësinë dhe performancën akademike. Vizioni i Kolegjit Profesional të Tiranës për përmbushjen e misionit të tij planifikohet të realizohet dhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit industrial perspektiv të vendit. Ai nuk bie ndesh me interesat tona kombëtare; ai është ndërtuar duke mbajtur parasysh synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar  [Evidence 3 Statuti KPT, neni 6]; [Evidenca 7 Strategjia 2021 -2025].
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e KPT për të formuar specialistë të lartë [Evidence 3 Statuti KPT, neni 31] dhe me planin e zhvillimit strategjik të tij, përmes të cilës, në kuadër të interesit rajonal, KLP synon, ndër të tjera, pajisjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike për të bërë të aftë në drejtime që kërkohen nga tregu i punës.  [Evidenca 7 Strategjia 2021 – 2025]
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	GVJ vlerëson se misioni, vizioni dhe objektivat strategjike janë të përcaktuar qartë , duke e vënë theksin në ofrimin e arsimit bashkohor profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, [Evidenca 7 Strategjia 2021 – 2025]; [Evidenca 3 Statuti, neni 5, 15] dhe krijimin e profesionistëve të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë me theks te cilësia ne pergatitjen e specialisteve ne kete fushe.  [Evidence 4 Rregullorja KPT]; [Evidenca 22 Laboratorët]
<b>Kriteri 4.</b> Programi i	Ne kuadër te hapjes se këtij programi, licensuar me Urdhërin

<p>studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>nr.375, datë 25.07.2017 të MAS, është kryer një studim i tregut të punës, përmes të cilit u evidentua nevoja dhe kërkesa e tregut të punës për profesioniste të pavarur në adresimin e nevojave të tregut të punës për profesioniste e teknikë të lartë në fusha të ndryshme të industrisë dhe shërbimit dhe zgjerimin në planin horizontal me programe e module të reja studimi.</p> <p>[Evidence 7.1 Strategjia 2015 – 2020]; [Evidence 1/1 Urdheri nr.375, datë 25.07.2017]; [Evidenca 31 Takimi me bizneset]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit profesional që ofrohet nga njësi bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka në përbërje: Staf akademik efektiv 8 anëtarë, nga të cilët: 2 me gradën Prof. Dr. dhe 6 me titullin Msc. [Evidenca 6.1 Tabela e stafit në vite]. Sipas nevojës, për këtë program studimi është angazhuar dhe staf akademik jo efektiv. Staf akademik i angazhuar në programin e studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij. KLP/Departamenti TI, disponon mbulon Laboratorë mësimorë dhe oficinën që është në dispozicion të këtij programi duke krijuar një bazë të rëndësishme infrastrukturore në mbarëvajtjen e këtij programi studimi [Evidence 34 Infrastruktura, Evidence 22 Laboratorët].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), si pjesë e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT), në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces [Evidenca 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve].</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), si pjesë e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT), është në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon infrastrukturën dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit</i></p>



	me karakter profesional në "Teknologji e Instalimeve Elektrike".			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ vëren se ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në Statutin e KPT (Kreu II, Kreu III, Kreu IV), rregulloren tij dhe në rregulloren e njësive kryesore. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar qartë në të, vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si nga Zyra e Kurrikulës, Zyra e Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës së Studentit dhe departamentet e tjera në KPT. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), personelit akademik nga Kolegji Profesional (KPT), si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre</p> <p>[Evidence 3 Statuti KPT Neni 14]; [Evidenca 9 Mbledhje Rektorati/ Departamenti/ Asamble]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ vlerëson nga dokumentacioni i paraqitur se KPT bashkëpunon me biznesin e industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura.</p> <p>Nga studimi i DVV dhe takimet ne Rektorat/ Departament evidentohet se KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik te Tiranës, Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe Universitetin European te Tiranës, Institutin Kanadez te Teknologjisë, te cilet ndodhen ne te njejtin kompleks [Evidence 10 - Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet]</p> <p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni</p>

*Handwritten signature and initials*

	<p>ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre vetëm për programin e studimit si kompania Warwick Shpk, Rey Plastica, Hidrocentralet Koka Ergi Energy shpk, PAT shpk. [Evidenca 33 Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit].</p> <p>KPT ka lidhur memorandum me Universitetin e Thesalisë, Greqi [Evidence 10.2 – MoU_UTH].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>GVJ konstaton se, procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës, ku janë parashikuar procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces brenda apo jashtë KPT. Aktualisht janë rreth 15 Marrëveshje të lidhura vetëm për këtë program studimi [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale].</p> <p>KPT është pjesë projekteve europiane, ku studentët janë gjithashtu pjesë aktive e tyre si pjesëmarrës në trajnime /workshop-eve, skemave të mobilitetit 1 dhe 3 mujore në vende të ndryshme të BE [Evidenca 21/1 Mobilitetet, Evidence 11.3 USIA].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KPT, ka realizuar një analizë të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit përgjegjës për programin e studimit. Në të ka raportim analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p><i>GVJ sugjeron që krahas rritjes së numrit të bashkëpunimeve, KPT të kujdeset edhe për hartim më të detajuar të raporteve analitike të përfitimit nga marrëveshjet.</i></p> <p>[Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale] [Evidence 5.2 Raporti i praktikave]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve në dosjen e akreditimit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se KPT ka organizuar instrumentë nxitëse dhe motivues në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve, siç është Klubit të Inovacionit KPT HUB, pjesëmarrjes në eventë të ndryshme të sipërmarrjes etj ku studentët marrin njohuri në lidhje me mënyrat e arritjes së suksesit në treg, KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Në programin e studimit TIE, përqindja e të punësuarëve është në nivelin rreth 90%, ku një pjesë e studentëve janë punësuar që gjatë praktikave</p>

	<p>profesionale 6-javore që zhvillojnë pranë institucioneve në terren si në Hidrocentralet Koka Ergi Energy shpk, PAT shp, Remonti Elektrik SHA, etj.</p> <p>[Evidence 12 Sondazhi Alumni]; [Evidence 44 Thirrje / Njoftime Punësimi]</p> <p>[Evidence 20 KPT HUB]; [Evidence 39 Connect IT Bootcamp]</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit.</i></p> <p><i>KPT falë bashkëpunimeve me entet vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, sugjerojnë që krahas rritjes së numrit të bashkëpunimeve, KPT të kujdeset edhe për hartim më të detajuar të raporteve analitike të përfitimit nga marrëveshjet.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë (SBC) në KPT, realizohet nëpërmjet strukturave hierarkike organizative dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel kolegji, të cilat së bashku planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e Akteve Rregullatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e tyre.</p> <p>KPT ka hartuar politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë.</p> <p>[Evidence 3 Statuti KPT neni 11]</p> <p><i>GVJ vëren se KPT i kushton vëmendjen e duhur sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me dispozitat e</i></p>





	<i>legjislacionit në fuqi dhe misionin e institucionit.</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ vëren, se KPT ka themeluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), e cila kryen punë të vazhdueshme për monitorimin e veprimtarisë së institucionit dhe sigurimin e cilësisë së brendshme. NjSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe syllabuseve mësimore, mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit akademik formuese e trajnuese nëpërmjet praktikave, monitorimit të sekretarisë mësimore si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të KPT si dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme.</p> <p>[Evidence 3 Statuti, Neni 16]; [Evidence 13 - Vendim i ngritjes së NjSBC]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NjSBC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale [Evidence 14 – Inspektimet].</p> <p>Akreditimi i parë i programit të studimit TIE është bërë me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 17, datë 02.03.2019, “Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”. KPT i është nënshtruar riakreditimit të jashtëm institucional dhe është vlerësuar pozitivisht me VBA Nr. 08, datë 27.01.2023 me një akreditim 5 vjeçar të vlefshëm deri në muajin Janar 2028. Institucioni gjithashtu, kujdeset dhe ndjek ri akreditimin e programeve të tij të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi [Evidenca 7 Strategjia 2021-2025, Kërkimi i tregut].</p> <p>GVJ vlerëson se KPT siguron cilësinë përmes monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, NjSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve me sondazhe dhe fokus grupe. NjSBC miraton planin e punës mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative të KPT duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm në vlerësim të aspekteve të ndryshme [Evidence 11.3 USIA Roundtable, Evidence 31 Takim Biznesi].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të</p>

*Sadman* ✓

<p>në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>veprimtarive mësimore në KPT, [Evidence 3 Statuti KPT].</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i performancën se personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga përgjegjësi i departamentit. Ai vlerëson performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit, [Evidence 13.2 Raporti NjSBC]; [Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente]; [ Evidence 16 Fokus Grupe].</p> <p>Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë, por nuk kufizohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit;</li> <li>- mundësitë e punësimit të të diplomuarve;</li> <li>- profilin e popullatës studentore;</li> <li>- raportin pedagog/studentë;</li> <li>- plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre;</li> <li>- efektivitetin e pedagogëve;</li> <li>- monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve;</li> <li>- numrin e stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen;</li> </ul> <p>NJBSC analizon vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe përgatit një raport. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të KPT. Ky raport i shkon gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë, i cili vë në dijeni të vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë periodike personelin akademik, [Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim akademik]; [Evidence 6.4 Anketa e Stafit]; [Evidence 9 Mbledhje e Asamblesë së Personelit, të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve]; (Evidence 11.3 USIA roundtable).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë është Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e cila kryen punë të vazhdueshme për monitorimin e veprimtarisë së institucionit dhe sigurimin e cilësisë së brendshme.</i></p> <p><i>NjSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit, për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në KPT në nivel Kolegji, e cila mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale.</i></p>

*Amara*



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologjia e Instalime Elektrike”, i ofruar nga Departamenti i Teknologjise se informacionit pranë KPT, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidenca 5.3 Plani mësimor]; [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit].
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i studimit profesional në “Teknologjia e Instalime Elektrike”, është strukturuar në lëndë/disiplina të cilat synojnë të japin njohuri baze teorike dhe kryesisht praktike, që studentet priten të ofrojnë në përfundim të studimeve të tija. Gjithashtu aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse [Evidence 18 Vizita / Praktika në Terren]; [Evidence 20 -


*Lumasa*



<p>akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>KPT HUB]; [Evidence 21 - Trajnime student]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi profesionale në “Teknologjia e Instalime Elektrike”, ka ndër objektivat kryesorë t’u mundësojë studentëve njohuritë me kryesore dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e instalimeve elektrike. Gjithashtu programi synon që studentët të jenë në gjendje të përcaktojnë zgjidhje të proceseve teknologjike në rolin e specialistit teknik të pajisjeve elektrike, studentet në këtë program studimi aftësohen në lidhje me shfrytëzimin e pajisjeve elektrike në tërësi dhe atyre elektronike në veçanti. GVJ konstaton se objektivat formuese të Programi Profesionale në “Teknologjia e Instalime Elektrike”, përmbushen.</p> <p>[Evidence 4 Rregullorja KPT, neni 34]; [Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ vëren se programi ka të përcaktuar qartë të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndëve plotësuese duke përmbushur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Programet e lëndëve në programin e studimit janë të shprehura në kredite të cilat konvertohen në ndarjen sipas raportit përkatës në orë leksione, ushtrime dhe laboratore, ku studentët frekuentojnë dhe ndjekin secilin prej tyre në ambientet dhe labororet e KPT, ose në raste të caktuara në biznese dhe industri si vizitat në terren [Evidence 18 Vizita / Praktika në Terren].</p> <p>Gjithashtu aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse dhe nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete si klubet studentore [Evidence 20 - KPT HUB], trajnime [Evidence 21 - Trajnime student], pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare [Evidenca 11.3 USIA].</p>



	<p>Detyrime përmbyllëse janë “Praktika Profesionale” (10 ECTS) dhe “Provimi i përgjithshëm përfundimtar, ose punim diplome” (7 ECTS).</p> <p>[Evidence 2 Statuti KPT, KREU V]; [Evidence 5.3 Plani mësimor]; [Evidence 4 Rregullorja KPT, neni 34]; [Evidence 5.3 Rregullorja e programit të studimit]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ vlerëson se KPT në pranimin e studentëve të rinj, bazohet në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KPT në infrastrukturë, burime njerëzore, analizave të tregut, ecurisë së programeve dhe punësimit të studentëve. Kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen nga Senati Akademik ato dërgohen pranë organeve përkatëse, vendosen në portalin U Albania si dhe bëhen publike e përditësohen në faqen e internetit të KPT. Pranohen për t'u regjistruar pranë KPT të gjithë ata kandidatë të cilët përmbushin kriteret e pranimit si dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj.</p> <p>[Evidence 3 Statuti KPT]; [Evidence 4 Rregullorja KPT]; [Evidence 7 Strategjia 2021 – 2025]; [Evidence 23 – Vendimet SA]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga hulumtimi në Web, GVJ kostaton se në Kolegjet Profesionale Elbasan, Durrës, Tiranë etj. nuk ofrohet program tjetër studimi me të njëjtën emërtesë “Teknologjia e Instalime Elektrike” dhe të kenë përmbajtje të ngjashme.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>KPT ka ndërmarrë procesin e kodifikimit të programeve të studimit që ofron, propozime të cilat janë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me shkresën Nr.495/2, Date 12.01.2023.</p> <p>[Evidence 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologjia e Instalime Elektrike” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve të aftë për tregun e punës. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të</i></p>





	<p><i>vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>KLP ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizita ne KPT vëren se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si njësi bazë përgjegjëse për këtë program përfshin fusha të përafërta dhe disiplina mësimore trajnuese të përafërta me programet e tjera që ofron. Në funksion të mësimdhënies janë dhe sekretaria mësimore dhe stafi administrativ të cilët bashkërendojnë punën e tyre.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës është i organizuar në 2 (dy) departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI);</li> <li>2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (DEMSA);</li> </ol> <p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, në përputhje me VKM Nr. 370, datë 26.04.2017 ku për tre vite akademike është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti akademik 2020-2021, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);</li> <li>• Viti akademik 2021-2022, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND);</li> <li>• Viti akademik 2022-2023, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND).</li> </ul>

	KPT është institucion i akredituar. Departamenti zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. [Evidence 3 Statuti, Neni 14]; [Evidence 3.1 Organigrama]; [Evidence 6.1 Të dhënat e stafit në vite]			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ vëren se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si njësi bazë për programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” përmbush detyrimet e përcaktuara për realizimin e praktikave mësimore. Pranë departamenti janë vënë në dispozicion laboratorë dhe ofcina. Gjithashtu studentët kanë mundësi të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte të ndryshme në praktikë brënda klubit të inovacionit KPT HUB  [Evidence 22 Laboratorët]; [Evidenca 20 KPT HUB]			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	DTI angazhon në kuadër të praktikave profesionale dhe laboratoreve staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre.  GVJ kostaton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, ka caktuar një pedagog si koordinator person përgjegjës për ndjekjen e studentëve në praktikat profesionale. Gjithashtu për ecurinë e praktikave profesionale që kontribuojnë në mbështetje të Departamentit është dhe Zyra e Karrierës dhe Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), si pjesë e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT), zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit. Në programin e studimit zhvillon mësim staf pedagogësh i kualifikuar të cilët kanë eksperiencë akademike dhe profesionale. Staf akademik i KPT është një kombinim i pedagogëve me tituj dhe me eksperiencë si dhe me pedagogë të ftuar që zotërojnë një punë në ushtrimin e profesionit të tyre</i>  <i>DTI plotëson kriteret ligjore duke angazhuar për vitin Akademik 2022-2023, 9 pedagoge si staf akademik efektiv (PAE) dhe 9 si PAK.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Teknologjise se Informacionit (DTI), pranë Kolegjit Profesional te Tiranës. DTI disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Kolegjit, rregulloren e Departamentit [Evidence 3 Statuti, Neni 13].</p> <p>Dokumentacioni i informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, gjenden në formë elektronike të disponueshme për të gjithë personelin akademik dhe administrativ të departamentit dhe publikun.</p> <p>[<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al">https://kolegjiprofesional.edu.al</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p><i>Programi i studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, vlerësohet nga GVJ si i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite organizuar në 4 semestra, me kohe te plote.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Kategoria A: 9 ECTS;</i></li> <li>- <i>Kategoria B: 60 ECTS;</i></li> <li>- <i>Kategoria C: 24 ECTS;</i></li> <li>- <i>Kategoria D: 20 ECTS;</i></li> <li>- <i>Kategoria E: 7 ECTS;</i></li> </ul> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor “Teknologji e Instalimeve Elektrike”]; [Evidence 5.5 Syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</p>	<p>Pranimi në programin 2-vjeçar të studimit Diplomë Profesionale në Teknologji e Instalimeve Elektrike” është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe nga KPT nuk është vendosur ndonjë kriter për notën mesatare. GVJ kostaton se rregullorja e KPT dhe rregullorja e programit të studimit jep informacionin dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve,</p>

*Adulana*

<p>ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>informacionet e nevojshme lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve. Dokumentat si më lart vihen në dispozicion të studentëve.</p> <p><i>GVJ vlerëson dhe rekomandon se KPT duhet të përmirësojë dhe detajojë informacionin në faqen e Web-it të institucionit për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve pasi një informacion i tillë mungon në faqen e Istitucionit.</i></p> <p>[Evidence 4 Rregullorja KPT]; [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit organizohet në lëndë, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidence 5.5 Syllabuset], janë hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, risjellin informacionet e nevojshme dhe detajuara për studentët lidhur me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, literaturën, organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit. Këto të dhëna detajohen edhe në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit, të cilat i vihen në dispozicion studentit.</p> <p>[Evidence 4 Rregullorja KPT, neni 34]; [Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidenca 5.3 Plani mësimor]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>GVJ vlerëson se Programi i studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” synohet të përditësohet në vazhdimësi nga DTI, duke marrë indicje nga takimet që organizohen pranë KPT dhe ato të pjesëmarrjes në evente, studime të tregut, kontaktet me biznesin etj.</p> <p>Në çdo rast këto ndryshime në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion bëhen dhe miratohen përpara fillimit të çdo viti akademik.</p> <p>[Evidence 5 - Strategjia e Zhvillimit 2021- 2025]; [Shenime nga Vizita në institucion]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë</i></p>

	<p><i>auditorit. Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën e praktiken bashkëkohore.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson dhe rekomandon se KPT duhet të përmiresojë dhe detajojë informacionin në faqen e Web-it të institucionit për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve pasi një informacion i tillë mungon në faqe.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Viti akademik është i organizuar në 2 (dy) semestra. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional të studentit. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë, që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës.</p> <p>GVJ vëren se gjatë zhvillimit lëndëve të programit profesional “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, ofrohen njohuri në fushën e instalimeve elektrike, që aftëson studentin mbi koncepte të sistemeve elektrike, shpërndarjes së energjisë; menaxherë të ruajtjes dhe kursimit të energjisë elektrike etj.</p> <p>Studenti gjatë zhvillimit të praktikës profesionale pajiset me kompetenca profesionale për të operuar në sektorin e instalimeve elektrike për t’ju përgjigjur detyrave që duhet të zgjidhe një specialist/teknik i pajisjeve elektrike. Programi profesional i studimit i ofruar nga KPT ka objektiva të mirë-përcaktuara për formimin e studentëve me njohuri teorike dhe praktike, aftësi dhe kompetenca profesionale.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani Mesimor i programit]; [Evidence 5</p>

	Rregullorja e Programit të Studimit]
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi profesional “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në diplomën profesionale në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimin profesional dhe kërkimit shkencor. Në vitin e I zhvillohen kryesisht lëndët bazë, ndërsa në vitin II zhvillohen lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore dhe përmbyllëse. Kjo mundëson që baza teorike e lëndëve të formimit bazë të shërbejë në përvetësimin më të mirë të dijeve prej lëndëve me karakter profesional. Lende të tilla si Furnizimi me energji elektrike i ndërmarrjeve, Instalimet Elektrike në Industri, Impiante elektrike, Teknologji e ndriçimit dhe praktika profesionale e planifikuar në plan mësimor, plotësojnë kërkesat për aftësimin e studenteve me shprehitë që kërkohen nga punëdhënësit</p> <p>[Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidenca 5.3 Plani Mesimor i programit]; [Evidence 5.5 Syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Gjatë intervistave me personelin akademik dhe me studentët evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e instalimeve elektrike.</p> <p>Sasia e orëve në auditor për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj.) rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 350 ore leksione;</li> <li>- 444/294 ore seminare/ laboratorë;</li> <li>- 210 ore Praktikë profesionale, pra rreth 21 % e programit mësimor i dedikohet aftësimin në praktikë të studentit;</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon që raporti i orëve në “Praktikë profesionale” të synojë të arrihet në 25 %.</i></p> <p>[Evidenca 5.3 Plani Mesimor i Programit]; [Evidenca 5.5 Syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit</p>	<p>Programi i studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe</p>

<p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e teknologjisë dhe instalimeve elektrike.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani Mesimor i Programit]; [Evidenca 5.5 Syllabuset]; [Evidenca 21/1 Mobilitetet]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>GVJ vëren se programet e lëndëve janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën më të re, të detyruar dhe ndihmëse. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit.</p> <p>[Evidenca 5.5 Syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Nga studimi i DVV dhe gjatë takimeve në KPT, GVJ kostaton se institucioni ka një bashkëpunim të mire me sektorin privat, ka ngritur sistemit e tutorazhit dhe analizon periodikisht kërkesat e tregut të punës si dhe vlerësimet ndryshimet mbi rezultatet e bashkëpunimit me kompanitë private duke garantuar një formim praktik të përshtatshëm të studentëve me kërkesat e profesionit në fushën e “Teknologji e Instalimeve Elektrike”.</p> <p>[Evidence 11.4 Zyra USIA]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumnetacionit dhe duke ju referuar syllabuseve të lëndëve verën se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të aftësive dhe kompetencave që synon programi. Në KPT funksion Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve e cila në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin e praktikave mësimore, si dhe lehtëson punësimin në tregun e punës për studentëve.</p> <p>[Evidenca 5.5 Plani Mesimor i Programit]; [Evidenca 5.5 Syllabuset]; [Evidence 18 Vizita / Praktika në terren]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën</i></p>



	<i>bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ vlerëson se KPT bën pëpjekje për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës duke përditësuar kurrikulat nëpërmjet marrjes në konsideratë të kërkesave të tregut të punës, në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë sipas rregullores së brendshme dhe aktet nënligore në fuqi [Evidence 7 - Strategjia e Zhvillimit 2021- 2025]; [Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim akademik].  KPT në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programeve ka shfrytëzuar sondazhet e intervistat me studentët e diplomuar dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës [Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente]; [Evidencë 16 Fokus Grupe].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga dokumentacioni dhe vizita ne KLP, GVJ vlerëson se bazuar në parashikimet e Statutit, Neni 46 është ngritur Këshilli i Studentëve dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrjen e organeve drejtuese të tij, organizimin e lirë, dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre. Studentët janë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore dhe në nivel institucioni.  [Evidence 3 Statuti KPT]
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet	KPT bazuar në ndryshimet e teknologjisë, nevojat e tregut të punës dhe duke përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një tregues të performancës së programit ka bere te mundur rritjen e cilësisë së mesimdhënies,

*Signature*



dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.	bashkëpunim me kompani e rrjete profesionistësh, dhe ka përmirësuar, përditësuar programin e studimit me synim transmetimin e aftësive dhe shprehive bashkekohore në fillim të çdo viti akademik.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i></p> <p><i>Programi i studimit Profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është rishikuar duke bërë edhe përmirësime të dukshme. Në riorganizimin e tij kontribut kanë dhënë të gjithë grupet e interesit duke shprehur qartas mendimin e tyre. Programi u ofron mundësi studentëve të marrin më shumë njohuri teorike dhe praktike. Baza laboratorike është përmirësuar duke sjell një përmirësim të dukshëm në drejtim të rritjes së kompetencave profesionale të studentëve</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike,	Në KPT, për programin “Teknologji e Instalimeve Elektrike” format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit, praktikat profesionale e mësimore të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Ndjekja e leksioneve është e

<p>detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>detyrueshme në masën mbi 50% të orëve. Pjesëmarrja është e detyruar në masën 75% të orëve të përgjithshme të ushtrimeve dhe laboratoreve. Praktika 6 javore pranë organizatave, kompanive dhe bizneseve që bashkëpunojnë.</p> <p>[Evidenca 22 Laboratorët]; [Evidenca 4 Rregullorja KPT]; [Evidenca 5.1. Rregullorja e praktikave profesionale]; [Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidenca 5.5 Syllabuset]</p> <p><i>Për një bashkëpunim efektiv me tregun e punës <u>GVJ rekomandon</u> ritjen e pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës jashtë KPT gjatë orëve të mësimin në KPT.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që aktivizohet në programin “Teknologji e Instalimeve Elektrike” paraqet një nivel të mirë akademik dhe profesional. Kjo ndërthurje e aftësive akademike me ato profesionale, i mundëson personelit akademik të ofrojë dhe transmetojë me kompetencë njohuritë dhe konceptet e lëndës së studentit. Formatet e procesit mësimdhënies dhe të mësimnxënies, të pasqyruara në sylabuset e lëndëve, janë në përputhje me diversitetin dhe nevojat e studentëve. Gjithashtu, KPT inkurajon stafin akademik në mënyrë të vazhduar të shkëmbejë përvoja të ndryshme të metodave të mësimdhënies.</p> <p>[Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumenteve konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në KPT ekziston praktika e shkëmbimit të përvojës dhe e praktikave të mira në fushën e mësimdhënies. Departamentet organizojnë pjesëmarrjen reciproke të anëtarëve të stafit në orët e mësimin të njëri tjetrit. KPT përgatit raportin e vlerësimeve të anketimit dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. KPT nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie.</p> <p>[Evidence 6.4 Anketa e Stafit]; [Evidence 25 Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual]; [Evidence 11.5 Thirrje për pjesëmarrje në projekte]; [Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>GVJ vëren se KPT është përpjekur të përzgjedhë stafin akademik me eksperiencën akademike, tituj apo grada shkencore dhe eksperiencë në veprimtarinë prodhuese. Ata janë</p>

shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënive të respektit të ndërsjellë mes tyre.

kompetentë në shpjegimin e njohurive të lëndëve duke ofruar trajtime të koncepteve bazë. Ata përdorin metoda interaktive me studentët gjatë zhvillimit të lëndëve, angazhojnë studentët në punë individuale dhe punë në grup.

*Nga analiza e Planit Mesimor v.a 2022-2023 dhe Syllabuseve v.a 2022-2023 mbështetur ne Evidencen 5.3 Plani mësimor "Teknologji e Instalimeve Elektrike" dhe Evidencen 5.5 "Syllabuset", për këtë program studimi, GVJ konstaton:*


*Ngarkesa ne Lende dhe Kredite/Ore per Stafin Efektiv (PAE)*

Nr	Lenda	Kategoria	Kredite (ECTS)	Ore gjithsej (Auditor)
1	Matematike	A	4	38
2	Fizike e Pergjitheshme	A	5	59
3	Bazat e elektroteknikes	B	6	66
4	Matje dhe Istrumenta	B	6	66
5	Sisteme elektronike dixhitale	B	6	66
6	Qarqe elektronike te fuqise	B	6	66
7	Anglisht	D	4	48
8	Bazat e Informatikes	D	6	66
9	PLC dhe rrjetat	C	6	66
10	Teknologji e ndricimit	C	6	66
11	Praktike	D	10	210
12	Diplome/Provim formimi	E	7	

*Ngarkesa ne Lende dhe Kredite per Stafin Jo Efektiv (PAK)*

Nr	Lenda	Kategoria	Kredite (ECTS)	Ore gjithsej (Auditor)
1	Instalime ne banesa	B	6	66
2	Impiante elektrike	B	5	54
3	Furnizimi me energji i ndermarrjeve	B	6	66
4	Istalime elektrike ne industri	B	6	66
5	Makina elektrike	B	6	66

	6	Sisteme diellore fotovoltaike	B	6	66
	7	Elemente te qarqeve elektrike nje dhe tre faze	B	7	73
	8	Shperndarja dhe perdorimi i Energjise elektrike	C	6	66
	<p>Nga analiza e Tabelave "Ngarkesa ne Lende dhe Kredite/Ore per Stafin (PAE) dhe (PAK), rezulton se 72 Kredite te programit te studimit, mbulohet nga stafi PAE dhe 48 Kredite ne 8 lende te programit te studimit nga stafi PAK.</p> <p><i>GVJ vlerëson se KPT, Departamenti i Teknologjise se informacionit per programin "Teknologji e Instalimeve Elektrike" duhet të përmirësoje rportin PAE/PAK duke rekrutur staf te ri dhe reduktoje ngarkesen Mesimore/Lendore per PAK. GVJ, rekomandon qe për vazhdimësinë në KPT te rekrutohet staf i ri me grada dhe tituj shkencore.</i></p> <p><i>[Evidenca 5.3 Plani mësimor "Teknologji e Instalimeve Elektrike"]; [Evidence 5.5 Syllabuset]</i></p>				
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	<p>GVJ vlerëson se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si njësia bazë përgjegjëse, përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike për rritjen e cilësinë se mësimdhënies duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet e hapura me ta për përmirësimin e formave dhe metodave te mësimdhënies në kete program studimi [Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente]; [Evidencë 16 Fokus Grupe]; [Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim]</p>				
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja	<p>KPT në statutin e tij ka përcaktuar Njesinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. NJBSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të institucionit. NJBSC bashkëpunon për çdo vlerësim te brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të NJBSC shërbejnë si bazë për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik</p> <p>[Evidence 13.1, Rregullore NjSBC, Evidence 13.2 Raporti NjSBC]</p>				



inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
<b>Konkluzione</b>	<p><i>KPT kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët. Për një bashkëpunim efektiv me tregun e punës <u>GVJ rekomandon</u> ritjen e pjesmarjes së ekspertëve të fushës jashtë KPT edhe gjatë orëve të mësimit.</i></p> <p><i><u>GVJ, rekomandon</u> përmirësimin e raportit në ngarkesën mesimore PAE/PAK në rekrutim të stafit të ri dhe në vazhdimësi të synohet për staf akademik me grada dhe tituj shkencore.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/ projekte/laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%).</p> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT]; [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe</p>

metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit. Informacioni sqarohet edhe gjatë Javës orientuese të fillimit të vitit akademik [Evidence 27 Manuali i Studentit]; [Evidence 29 Java e Orientimit]; [Evidence 5.5 Syllabuset]			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” dhe kostaton se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Testimi dhe vlerësimi në KPT është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike. [Evidence 4 Rregullorja KPT]; [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidence 27 Manuali i Studentit]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ vlerëson se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm: Provimit përfundimtar (60%)Kolokiume/projekte/laboratore (30%);Aktivizimi në ushtrime (10%). Nga takimi me studentët GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive. [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]

*Kamasa* 

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit per “Teknologji e Instalimeve Elektrike” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Testimi dhe vlerësimi në KPT është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidenca 27 Manuali i studentit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit vlerësohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimit përfundimtar (60%)</li> <li>• Kolokiume/ projekte/laboratore (30%)</li> <li>• Aktivizimi në ushtrime (10%)</li> </ul> <p>Sa më sipër evidentohet qartë në silabusin e cdo lënde. Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura</p> <p>[Evidence 4, Rregullorja KPT]; [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]; [Evidence 5.5 Syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se KPT ka përcaktuar në rregullore modalitetet për miratimin e komisioneve te provimeve. Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Testimet shoqërohen me komente për problematikat duke evidentuar mangësitë dhe problemet e kontrollit të dijeve.</p> <p>[Takimi me studentet]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët vlerëson se në KPT gjatë provimeve/testimit të njohurive ndodh monitorimi i procesit për të garantuar një proces cilësor dhe të rregullt duke mos lejuar kopjimin dhe prishjen e rregullit.</p>

<p>provime dhe detyra.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës.</li> <li>2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi.</li> <li>3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit.</li> </ol> <p>[Evidence 4 Rregullorja KPT]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB, vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente nga pedagogu. Një seancë sqaruese zhvillohet pas testit. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilesinë e punimeve të tyre. Edhe në takimin me studentët u konfirmua se procedura e kontrollit të dijeve dhe dhënia e rezultateve bëhet kryesisht sipas rregullores së Departamentit dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin.</p> <p>[Evidence 5 Rregullorja e Programit]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të rregullorja e programit të studimit vëren se në të parashikon të drejtën e ankimit / apelit të studentit dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin.</p> <p>[Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studentit, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i DTI ose Rektori ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit</p>





	<p>së bashku me arsyetimin përkatës. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar.</p> <p>[Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit].</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>DTI në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit me karakter profesional GVJ konstaton se synohet formimi i specialistëve në nivel profesional. Bazuar në kurrikulën e tij dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, ky program zhvillon dijet e studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e instalimeve elektrike. Programi i Studimit ndërthur njohuritë teorike dhe elementët praktikë, që shërbejnë për të zhvilluar aftësitë. Programi i studimit jouniversitar, me natyrë profesionale, synon ta pajisë studentin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. njohuri tekniko-praktike që kërkohen nga fusha të ndryshme të sistemeve elektrike dhe aplikimeve elektrike;</li> <li>b. aftësi për zgjidhjen e problemeve elektrike</li> <li>c. aftësi për t'u përshtatur me lehtësi me evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë;</li> <li>d. njohuri të thelluara në aspektet metodologjike dhe aplikative si dhe të jenë në gjendje të përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet e ndryshme në praktikë.</li> </ul>



	<p>e. përvojë praktike profesionale për të pasur sukses në tregun e punës.</p> <p>[Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit, Evidence 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit, Evidence 46 Broshura KPT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit me karakter profesional zhvillon aftësi të veçanta në fushën e instalimeve elektrike përmes lëndëve karakterizuese sipas drejtimeve që ka programi i studimit. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit të teknologjisë elektrike.</p> <p>[Evidence 5.3 Plani mësimor]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë orëve të fundit të mësimin, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara. GVJ vlerëson se stafi akademik i KPT, në përfundim të çdo semestri, shqyrton kompetencat dhe aftësitë që studenti ka përfituar duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Plani mësimor], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.</p> <p>Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. GVJ vlerëson se procesi i mësimdhënies u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në ushtrime, punë laborator, detyra kursi, praktika profesionale. KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me tri IAL vendase, ka bashkëpunime në nivel rajonal në Europë, si dhe është pjesë e projekteve europiane</p> <p>[Evidence 22 Laboratorët]; [Evidence 10 Lista e</p>

*Karacasu* 

mobilitetin e studentëve.	marrëveshjeve IAL-Marreveshjet]			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ nga takimet në KPT vlerëson se institucioni nxit organizimin e orëve të hapura dhe forume si një formë e ndarjes së përvojës, risive dhe inovacionit. Stafi akademik organizon orë të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë.  [Evidence 31 Prezantimet në Departament]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën profesionale, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e Teknologjive më të reja në Instalimet Elektrike.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Nga vlerësimi i dokumentacionit GVJ vlerëson se KPT ka një rregullore të programit të studimit dhe në të specifikohet qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Këto detyrime i komunikohen studentit dhe behen publike. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar ose mbrojtjes së një punimi të Diplomës [Evidence 4 Rregullorja KPT]
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ vlerëson se Kolegji Profesional i Tiranës ju vjen në ndihmë studentëve për të shlyer në kohë detyrimet përmbyllëse. Stafi akademik në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore përcaktojnë orare mbi konsultime për provimet, takime sqaruese me studentët për dhënien e informacioneve që lidhen me mbarëvajtjen e detyrimeve përmbyllëse.  [Evidence 4 Rregullorja KPT, kreu IX]; [Evidence 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale]; [Evidence 5.2 Raporti

*Samir*

	i praktikave]
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në KPT gjatë përgatitjes së procesit bazuar në rregulloren e programit të studimit TIE dhe të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti, përcakton lëndët më të përshtatshme, lëndët themeltare që duhet të përmbajë provimi përfundimtar. Provimi përfundimtar është i ndërtuar nga pesë sesione pyetjesh përkatësisht për gjashtë lëndë të ndryshme. Rëndësia dhe pesha e secilës lëndë në provimin përfundimtar përcaktohet me bazë përqindjeje dhe total pikësh të shpërndara për cdo pyetje, respektivisht për secilën lëndë  [Evidence 50 Programi dhe Model teze]
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në bazë të dokumentacionit, përfundimi i studimeve bëhet nëpërmjet një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës.  [Evidence 4 Rregullorja KPT, kreu IX]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Nga vizita ne KPT, GVJ vlerëson se në vitin e dytë studentët zhvillojnë praktikat profesionale pranë bizneseve që lidhen me fushën e veprimtarisë së programit të studimit, te cilat zgjasin 6 jave mësimore dhe ndiqen në vazhdimësi nga petagogu mbikëqyrës.  [Evidenca 22 Laboratorët]
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e KPT ka të përcaktuar mënyrën dhe rregullat për vlerësimin e dijës të provimeve përmbyllës që student duhet të ndjekin si edhe rregullat e hartimit të tezave dhe sekretimit.  [Evidence 4 Rregullorja e KPT, KREU V]

*Handwritten signature and initials in blue ink.*

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ vlerëson se programet e studimit profesionale në KPT realizohen me 120 kredite. Kohëzgjatja normale është 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tyre do të lëshohet “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimit të kryer i miratuar përkatësisht nga QSHA</p> <p>[Evidence 1 VKM numër 699, datë 26/08/2015]; [Evidence Diploma dhe miratimi i modelit të Diplomës]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga dokumentacioni GVJ vlerëson se KPT ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT.</p> <p>Bazuar në Statutin e KPT, Neni 48 - Dokumentacioni i procesit mesimor dhe i të dhënave të studentëve, KPT mban në formë të shkruar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Regjistrin themeltar të studenteve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studenteve në KPT;</li> <li>2. Regjistrin e arritjeve akademike që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga cdo student i regjistruar në KPT;</li> <li>3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emërtimin e tyre nga KPT;</li> </ol> <p>Regjistrat shpërndahen nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së KPT. Regjistrat plotësohen edhe në formë elektronike. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit. [Statutin e KPT, Neni 48]</p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji e Instalimeve Elektrike" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me Diplomë "Profesionale" në "Teknologji e Instalimeve Elektrike" në Kolegjin Profesional të Tiranës (KPT), referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>GVJ vlerëson se KPT ka një strategji për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik dhe studentët u konfirmua se përgjithësisht mësimdhënia tradicionale kombinohet me veprimtari ushtrimore si aplikimi përmes softwareve i koncepteve teorike. Infrastruktura e përshtatshme e mundësuar prej KPT e bën këtë gjë të arritshme.</p> <p>[Vizita ne institucion]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>GVK vlerëson se vlerësimi i aftësive të personelit në KPT kryhet në format vijuese nga përgjegjësi i departamentit, nga studentët, nga Zyra e BNj dhe NjSBC.</p> <p>[Evidence 3 Statuti]</p> <p>[Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore]</p> <p>[Evidence 13.2 Raporti NjSBC]</p> <p>[Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente, Evidence 16 Fokus Grupe]</p> <p>[Evidence 6.4 Anketa e Stafit]</p>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat	Nga vizita në institucion NjSBC, si strukturë përgjegjëse,

*Handwritten signature and initials in blue ink.*

përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	informon drejtuesit e Departamenteve, e përmes tyre të gjithë stafin e KPT, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, njësive të tij bazë dhe anëtarëve të personelit.  [Evidence 13.1 Rregullore NjSBC]; [Evidence 13.2 Raporti NjSBC]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga vlerësimi pranë Kolegji Profesional i Tiranës vihet re se ai ndihmon stafin akademik në rritjen profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminare, mbledhje apo forume të ndryshme që i aftësojnë ata në metoda të mësimdhënies. Organizohen orë të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie.  [Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve]  [Evidence 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT]  [Evidence 19/1 Kërkimi i aplikuar]  [Evidence 31 Prezantimet në Departament]			
<b>Konkluzione</b>	Në KPT funksionon Zyra e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila në bashkëveprim me Përgjegjësin e Departamentit TI, Zyren e BNj dhe NjSBC promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.  <i>DTI monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

*Samir*


**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit që mbulon programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, përbëhet nga pedagogë me eksperiencë pedagogjike dhe profesionale dhe kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shyrtimi i DVV, takimet me drejtuesit e institucionit, vezhgimi i dokumentacionit në Sekretarinë mesimore dhe dosjeve në zyrën e personelit, GVJ evidenton se:</p> <p>Për realizimin e programit të studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” është angazhuar staf akademik PAE/PAK për katër vitet e fundit akademike si më poshtë:</p> <p>v.a. 2020 – 2021 – 10/3  v.a. 2021 – 2022 – 9/4  v.a. 2022 – 2023 – 7/8  v.a. 2023 – 2024 – 8/6</p> <p>[Evidence 29, Manuali i Burimeve Njerëzore] dhe [Evidence 6.1, Të dhënat e stafit në vite]</p> <p>Aktualisht Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka në përbërje Staf akademik efektiv 8 anëtarë, nga të cilët: 2 me gradën Prof. Dr.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mesimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kontratave individuale të punës GVJ kostaton se ngarkesa mesimore përcaktohet sipas kualifikimit dhe përvojës në mësimdhënie të stafit, si dhe në harmonizimin e saj me ngarkesën dhe angazhimeve/punëve të stafit akademik me veprimtari të tjera mbështetëse me natyrë akademike për institucionin si tutoriati, këshillim akademik, praktikat profesionale. Ngarkesa mesimore e parashikuar në kontratën e stafit akademik efektiv është në përputhje me kriteret e akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Nga studimi i tabelave rezulton që për 3 vitet akademike 2020-2023, ngarkesa mesimore për programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, është <b>përbulluar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë</b>, sipas VKM</p>






	<p>Nr. 418, datë 10.05.2017</p> <p>[Evidence 29/1 Dosja e Personelit] ; [Evidenca 29/3 - Vendimi i Rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin Efektiv] ; [Evidence 29/2 – Kontrata tip e punës].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita ne zyren e burimeve njerezore kostatojme se Institucioni ka lidhur kontratat e punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, në të cilat parashikohet mbulimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV vihet re një qëndrueshmëri e stafit ndër vite.</p> <p>[Evidence 3 – Statuti, neni 37 (2)] ; [Evidence 29/2 Kontrata e tip e punës].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit, të mbështetur në kritere të përgjithshme, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kritere specifike sipas nevojave të Departamenteve dhe programeve të studimit që ofron, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit [Evidence 3 Statuti, neni 39].</p> <p>Nga GVJ, u shqyrtuan dy praktika rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”. Në to ishin paraqitur kritere të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperiencia në punë, kualifikimi shkencor. Në kërkesën e departamentit shprehet edhe fusha për të cilën kërkohet rekrutimi i stafit, duke listuar lëndët në të cilat do të angazhohet në mësimdhënje. Në dy praktikatat e shqyrtuara, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifike të shpallura. Komisioni i vlerësimit ka bërë renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mirë kërkesat për vëndin e punës dhe ja ka përcjelle Rektorit per vendimarrje [Evidence 29 - Manuali i Burimeve Njerezore / Procesi i rekrutimit].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e</p>	<p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, garanton angazhimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik për realizimin korrekt të orëve laboratorike të parashikuara në programin e studimit, si dhe mirëmbajtjen e ambjenteve dhe pajisjeve laboratorike përkatëse. Kjo është një vlerë e vecantë per KPT qe ofron laboratorë modernë të markave lider</p>



<p>orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>[Evidenca 22 Laboratorët].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ.</p>	<p>KPT, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron. Kjo zyre ndjente përgjegjësinë për ruajtjen e këtij informacioni, i cili vihet në dispozicion të njësisë bazë të Institucionit sipas nevojave të tyre. Administrimi i dosjeve të personelit të KPT bëhej duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale [Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore, Evidence 29/1 Dosja e personelit].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 38 subjekte ku nga keto 31 private dhe 7 publike, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të fushes dhe te perafert me programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” [Evidenca 33 - Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit].</p> <p>Këto institucione vënë në dispozicion të studentëve personelin e kualifikuar për mbikëqyrjen e praktikës profesionale, i cili mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre. Gjithashtu KPT për mbarvajtjen e praktikës profesionale në çdo kontratë të nënshkrur ka përcaktuar ndër të tjera studentët praktikantë, afatin e praktikës, detyrimet e palëve etj [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të</p>	<p>Në takimin e GVJ me Rektoren, Përgjegjës të Departamentit dhe dokumentat e DVV, na u perforcua bindja se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky specialist është pikë kontakti me KPT dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant (Evidenca 5.1 Rregullorja e</p>


*Kallio*



<p>ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>praktikes profesionale, Neni 4). GVJ konstaton se DTI ka ngarkuar dhe ka vënë në dispozicion të praktikave profesionale një personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për ndjekjen e tyre në terren, për orientimin dhe instruktimin e studenteve sidomos me masat e sigurimit teknik [Evidence 5.1 “Rregullorja e praktikës profesionale KPT”/ Evidence 5.4 Dosja e praktikës].</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, është angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë dhe personel ndihmës akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi, nevojat dhe specifikat e programit.</i></p> <p><i>Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Ngarkesa mesimore mbulohet kryesisht nga personeli akademik efektiv dhe lende specifike nga ai me kontratë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku për 3 vitet akademike 2020-2023, ngarkesa mesimore për programin e studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me rreth 31 kompani dhe institucione private dhe 7 shtetërore të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e Teknologjisë e Instalimeve Elektrike mundëson dhe garanton realizimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve. Aktualisht Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka në përbërje Staf akademik 2023 9 anëtarë, nga të cilët: 2 me gradën Prof. Dr.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Institucioni</b></p>	<p>Godinat e Kolegjit Profesional të Tiranës janë të vendosura</p>

*Kamran*



<p>siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>brenda kompleksit të ndërtesave, të quajtur “Kompleksi Xhura”. Gjate vitit 2020 kompleksi i është nenshtuar rikonstruksionit me materiale ndërtimi cilësore që garantojnë një izolim të sigurt nga zhurmat dhe akustikën e duhur. Objektet janë të pajisura me mjete mbrojtjes kundër shkarkimeve elektrike (4 rrufepritëse) dhe paisje të mbrojtjes nga zjarri.</p> <p>Për sa i përket hapësirave akademike, ato janë të bollshme në aspektin e sipërfaqes, lartësisë, ndriçimit dhe ajrosjes. Çdo kat është 4 metra i lartë. Mësimi organizohet në grupe mësimore në përputhje me parashikimet ligjore për këtë natyrë prprogrami studimi: grupe deri në 25 studentë në ushtrime, grupe me 10 -12 studentë në laborator.</p> <p>Nga perpunimi statistikor i të dhënave dhe bazuar ne normat dhe standardet që kerkohen, GVJ konkludon se Auditorët, laboratorët, bibliotekat e ambjentet për stafin akademik dhe për studentët etj, plotësojnë nevojat për mbarëvatjen e programeve të studimit të ofruara nga KPT dhe specifikisht për programin e studimit “<i>Teknologji e Instalimeve Elektrike</i>” [Evidenca 34 Infrastruktura].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Auditorët dhe laboratorët e KPT janë të pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit, stenda dhe projektorë, smartboard etj. duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe gjatë vizitës në institucion, u konstatua se KPT siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse [Evidenca 34 Infrastruktura, Evidenca 34/1 Infrastruktura IT, Evidenca 22 Laboratorët].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin</p>	<p>Mjediset mësimore laboratorike janë të pajisura me pajisjet e nevojshme për zhvillimin sa më efikas dhe cilësor të procesit mësimor. KPT disponon gjithsej 12 laboratore, ku nga keta 6 mbulojnë drejtpërdrejt programin profesional <i>Teknologji e Instalimeve Elektrike</i> dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik [Evidence 34 Infrastruktura, Evidence 22 Laboratorët].</p>

e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion të programit të studimit edhe 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit me 25 poste pune të pajisur me programe profesionale, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili që përdoren në salla të ndryshme sipas nevojës, dhe një pool prej 10 laptop.								
<b>Konkluzione</b>	<i>KPT, DTI ka në dispozicion ambiente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji e Instalimeve Elektrike", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.</i>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në bibliotekën mësimore të KPT vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji e Instalimeve Elektrike", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve [Evidence 34/2 – Rregullorja e Bibliotekës, Evidence 34/3 Karta e bibliotekës].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në	Biblioteka mësimore i shërben zhvillimit të procesit mësimor

<p>dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>– akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Fondi i Bibliotekës pasurohet periodikisht nëpërmjet abonimeve në biblioteka dhe revista online [Evidence 34/4 – Biblioteka online], blerjeve të financuara nga KPT, donacioneve etj. dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palë të treta.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Kolegjit Profesional të Tiranës bazuar në syllabuset e lëndëve të parashikuara në këtë Program studimi dhe në literaturën e kërkuar, ka aktualisht në fondin e saj një numër të konsiderueshëm librash mësimorë bazë dhe ndihmëse sipas profilit të lëndëve në programin e studimit. Kolegji në vazhdim e pasuron këtë bibliotekë me literature bashkëkohore dhe të përshtatshme për programin e studimit [Evidence 5.5 Syllabus].</p> <p>Për të siguruar cilësi në mësimdhënie, biblioteka mësimore, disponohen tekste në shqip dhe gjuhë të huaja. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimor – akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, ka vënë në dispozicion falas dhe me kushte për akses të barabartë, bibliotekën mësimore dhe bibliotekat online për të cilat institucioni ka bërë abonim.</p> <p>KPT ka krijuar <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/online-library-oer">https://kolegjiprofesional.edu.al/online-library-oer</a> (Open Educational Resources (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore të cilat janë lëshuar nën një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimi dhe rishpërndarja nga të tjerët pa kufizime ose të kufizuara, si dhe ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar apo që janë me akses të lirë si openlibrary.org, link të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës së Shtetit etj.</p> <p>Studentët përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund të shfrytëzojnë edhe platformat online si Sharefolder, e cila aksesohet vetëm nga kompjuterat e lidhur në rrjetin e KPT.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Biblioteka ofron të gjitha kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimor – akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen. Ajo ka një rregullore e cila është e</p>



shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	shpallur në ambientet e saj së bashku me oraret e punës. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi. Biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi [Evidence 34/2 – Rregullorja e Bibliotekës].
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga vëzhgimi në ambiente dhe takimi me studentet, nga GVJ u konstatua se organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës, rregulloheshin me rregullore e veçantë e cila ishte e shpallur në ambientet e saj. Orari i punës në bibliotekë është përshtatur sipas programeve të studimit nga e Hëna-Premte 9:00 - 20:00 e Shtunë 9:00 - 17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksiononte me orar të zgjatur.
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	KPT ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në përputhje me nevojat e programeve të studimit, si dhe analizon vazhdimisht shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij <i>online</i> nga personeli akademik dhe studentët duke marrë masa në funksion të saj.
<b>Konkluzione</b>	<i>Në bibliotekën mësimore të KPT vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji e Instalimeve Elektrike", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në</i>

	<i>dispozicion të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>KPT disponon nje Sistem te Informatizuar të mundësuar në bazë të kontratës përkatëse të lidhur me shoqërinë Tech360 qe është një platformë, e cila krijon mundësinë e personalizimit sipas nevojave dhe specifikave të institucionit. Aplikacionet në nivel institucioni janë të vendosura në Classter i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimit të informacionit të Studentëve.Në Classter manaxhohet informacioni i cili lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimit, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës. Menaxhimi i të gjithë informacionit të brendshëm që përfshin anën administrative (zyra e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, etj) dhe anën akademike (stafi akademik, studentët) bëhen nëpërmjet platformës së sistemit të menaxhimit të informatizuar.</p> <p>Përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe akteve nën ligjore në fuqi. Përdorimi i sistemit të informatizuar është në ndihmë edhe të sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjitha instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra.</p> <p>Përdorimi efikas i këtij sistemi menaxhimi lehtëson punën e cdo hallke në KPT [Evidence 28/1 Sistemi Classter].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit</p>	<p>Nëpërmjet Sistemit Classter, Kolegji Profesional i Tiranës manaxhon informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet të cilat lidhen me personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrative. Ky informacion përpunohet dhe administrohet nga personeli përgjegjës i</p>

*Handwritten signature*





<p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse. Dosjet fizike të Personelit mbaheshin në Zyrën e Burimeve Njerëzore [Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter] ; [Evidence 29/1 Dosja e personelit].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në privilegjet dhe hirearkinë e përdoruesit, garantohet edhe qasja në informacionet e menaxhuara. Aksesit është i ndarë në 3 lloje :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Share Folder (nivel lokal) i cili përdoret për të shkëmbyer materiale në rang Administrate, Stafi Pedagogjik , Pedagog – Student, materiale për studentet etj.</li> <li>• Share Point (One Drive) pjesë e Office365 ku aksesit mund të lejohet ose jo brenda organizatës , për studentet dhe stafin. Gjithashtu integrimi me platforma të tjera si Forms, Teams, Stream për të mundësuar komunikim të sigurt dhe lehtësisht të aksesueshëm.</li> <li>• Nepermjet sistemit të menaxhimit Classter pedagogu mund të mundësojë studenteve materiale si literaturën, syllabuse, ushtrime etj, i cili është i integruar Office365 për të lehtësuar aksesimin e të dhënave.</li> </ul> <p>I gjithë sistemi informatik, si ai i ndërtuar dhe mirmbajtur nga institucioni, si ato të përdorura nga platforma komerciale Microsoft të përdorura nga KPT, kanë qasje bazuar në përdorues /fjalëkalim(duke zbatuar procedurat e sigurisë se informacionit ISO27001).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në përdorim platformë dhe module të vecanta që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve (Platforma Microsoft Teams dhe Classter e cila përdoret online dhe aksesohet nga studentët dhe stafi akademik për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik).</p> <p>Portali i Studentit Classter ofron akses dhe të mundëson, orarin mësimor, të shikojë programet e lëndëve, pikët për çdo lëndë dhe njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitetet që zhvillohen.</p> <p>[Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter].</p>

*Sadiku* 

<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion sistemin e menaxhimit, platformën Classter me anë të cilit garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Me anë të sistemit Classter mundësohet raportime individuale me të dhëna në kohë reale për çdo strukturë, organet drejtuese dhe titullarët [Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në funksion faqen zyrtare të internetit <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/">https://kolegjiprofesional.edu.al/</a> në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në KPT përgjatë gjithë vitit, si dhe shërbimet e ofruara për studentët. [Evidence 35 Politika e Mirëmbajtjes së faqes së internetit].</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës disponon një faqe Web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht, ku KPT ka në përdorim platformë dhe module të vecanta që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve (Platforma Microsoft Teams dhe Classter e cila përdoret online dhe aksesohet nga studentët dhe stafi akademik për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik).</i></p> <p><i>Portali i Studentit Classter ofron akses dhe të mundëson, orarin mësimor, të shikojë programet e lëndëve, pikët për çdo lëndë dhe njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitetet që zhvillohen.</i></p> <p><i>Në Web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit**



**institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifin e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të KPT, financimi nga ortakët e KPT shpk në cilësinë e pronarit, të ardhura nga shërbimet që KPT ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Tarifin janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit të KPT për çdo vit akademik (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifin-e-studimit-dhe-bursat/">https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifin-e-studimit-dhe-bursat/</a>).</p> <p>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhen në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standartet Kombëtare të Kontabiliteti.</p> <p>KPT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston për të gjithë institucionin, ashtu si dhe për programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total / shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament [Evidenca 16 Raporti Vjetor].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës.</p> <p>Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>



<p>lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p> <p>Funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPT i cili është një urë komunikimi dhe me Asamblenë e Ortakëve të KPT shpk.</p> <p>Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjëndjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e pavarur</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifën e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të KPT, financimi nga ortakët e KPT shpk në cilësinë e pronarit, të ardhura nga shërbimet që KPT ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Tarifat janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit të KPT për çdo vit akademik (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifate-studimit-dhe-bursat">https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifate-studimit-dhe-bursat</a>)</p> <p>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhen në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p> <p>KPT shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston për të gjithë institucionin, ashtu si dhe për programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total / shpenzime të</p>

	departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. Ndonëse aktiviteti i shoqërisë KPT shpk është i gjerë, aktualisht i vetmi aktivitet që shoqëria zhvillon është ai i arsimit profesional të lartë në përputhje me licencën e marrë nga organet kompetente [Evidenca 36 -Raporti Vjetor].			
<b>Konkluzione</b>	<i>KPT dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit "Teknologji e Instalimeve Elektrike" dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundur ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij, e shprehur kjo në statutin e KPT, [Evidenca 3-Statuti i KPT], e cila i dedikohet tërësisht zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të studimit dhe të procesit mësimor nga hyrja deri në dalje (diplomim) [Evidenca 4-Regullorja e KPT].
	Kuotat e studentëve për cdo program studimi, miratohen cdo fillim viti akademik me vendim senati akademik. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma dhe në

	<p>format elektronike në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës në internet: <a href="http://kolegjiprofesional.edu.al/">http://kolegjiprofesional.edu.al/</a></p> <p>Gjithashtu informacioni i nevojshëm merret edhe në sistemin e informacionit Classter, i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimimit të informacionit të Studentëve. Në tabelen e mëposhteme jepet numri i studentëve të regjistruar, në programin e studimit TIE për vitet akademike nga 2017-ta deri në 2023-shin.</p> <table border="1" data-bbox="651 568 1399 736"> <thead> <tr> <th colspan="7">Vitet Akademike</th> </tr> <tr> <th>2017</th> <th>2018</th> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2022</th> <th>2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>11</td> <td>15</td> <td>25</td> <td>9</td> <td>14</td> <td>17</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table> <p>Numri i studentëve të regjistruar, në programin e studimit TIE për vitin akademik 2023-2024 ” është 19 studentë.</p>	Vitet Akademike							2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	11	15	25	9	14	17	19
Vitet Akademike																						
2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023																
11	15	25	9	14	17	19																
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KPT është Institucion i arsimit të lartë profesional dhe programet e ofruara janë më natyre profesionale dhe në momentin e aplikimit për kandidatët nuk ka kushte për notën mesatare. Kriteret për çdo vit akademik publikohen në faqen e internetit të KPT <a href="http://kolegjiprofesional.edu.al/">http://kolegjiprofesional.edu.al/</a></p> <p>.Institucioni garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, duke bërë transparente kriteret dhe procedurat që nga momenti i hyrjes deri në dalje. Në bazë të akteve rregullatore të KPT, dhe procedurave për pranimin e regjistrimit të studentëve, në çdo program studimi, pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës.</p>																					
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe</p>	<p>KPT, për çdo vit akademik përcaktohen me vendim senati kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi aktiv në të dy Departamentet e tij, [Evidenca 23 Vendimet SA].</p> <p>Sipas akteve ligjore në fuqi, çdo vit KPT dorëzon kriteret e pranimit të studentëve pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të kuotave përkatëse për çdo program në</p>																					



<p>udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>përputhje me kapacitetet që disponon IAL dhe që i nënshtrohen verifikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Për regjistrim pranë KPT, kandidatët dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Kontratave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Fotokopje të noterizuar të të Diplomës së Maturës Shtetërore ose të deftesës së pjekurisë së bashku me certifikatën e notave ose të një deftese/ diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar nga MAS;</li> <li>Çertifikatë familjare;</li> <li>Dokumentin e identifikimit (fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës);</li> <li>Çdo dokument tjetër të përcaktuar si të nevojshëm nga legjislacioni në fuqi dhe KPT;</li> </ol> <p>Pas dorëzimit të dokumenteve të mësipërme lidhet kontrata e regjistrimit mes Kolegjit Profesional të Tiranës dhe studentit.</p> <p>Kriteret janë të publikuara në faqen e internetit të KPT <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/">https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/</a>, dhe respektojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, u bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve në ambientet e KPT, faqen e internetit. Për studentët e rinj të regjistruar realizohet Java e Orientimit, e kthyer në traditë, ku jepen sqarime për sistemin e studimeve, vlerësimit, rregulloreve dhe procedurave administrative të KPT; njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi etj [Evidence 30 Java e Orientimit].</p> <p>Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion silabusi për çdo lëndë e programit të studimit. Pjesë e silabusit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit [Evidence 5.5 Syllabuset].</p> <p>Informimi nëpërmjet këtyre formave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Organizim i takimeve informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere të përfaqësuesve të KPT me nxënësit e shkollave të mesme;</li> <li>➤ Organizimi i tryezave të rumbullakëta, dhe i</li> </ul>

*Lamaou*

	<p>veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënësit e shkollave të mesme të vendit në mjediset e Kolegjit Profesional të Tiranës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përgatitje e shperndarje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuere (si fletëpalosje, postera, broshura etj.), dhe të materialeve audio vizive ne media te ndryshme si: spote promocionale, mesazhe promocionale etj;</li> <li>➤ Dalje publike të përfaqësueseve të KPT në media dhe /ose evente të ndryshme dhe pjesëmarrje në panaiere dhe/ose evente të tjera të ngjashme;</li> <li>➤ Komunikim nëpërmjet faqes zyrtare të KPT dhe / ose llogarive në rrjetet sociale;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta në programet e studimit që ofron [Evidence 3 – Statuti, neni 6 (2) (b)].</p> <p>Në lidhje me personat me aftësi ndryshe, KPT disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrja në KPT është në nivel toke, çka e bën lehtësisht të aksesueshme;</li> <li>• Tualete për personave me aftësi ndryshe</li> <li>• Në rast të studentëve me aftësi ndryshe, është parashikuar që mësimi të zhvillohet në mjedis lehtësisht të aksesueshme për ta.</li> </ul> <p>Në lidhje me studentët e pakicave rome dhe ballkano-egjiptiane, KPT në vijimësi ka bërë parashikime në kuota por nuk ka pasur raste të tilla.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për përfshirjen e studentëve në programet prioritare në përputhje me VKM Nr. 386, datë 01.06.2022.</p> <p>KPT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPT dhe ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët (si psh Bootcamp i sipërmarrjes, Connect IT projekt i GIZ dhe Bashkimit European etj). [Evidence 39 Connect IT etj].</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat</i></p>

*Samusu*





	<p>garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, vendas dhe të huaj, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit, që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.</p> <p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, janë të shprehura qartë në aktet rregullatore të Institucionit.</p> <p>Institucioni ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta në programet e studimit që ofron.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.2


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatoren e programit të studimit dhe përgjegjës të grupit të tyre mësimor mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik [nga protokoli i takimit të GVJ me studentet dhe personelin akademik e mbeshtetes].</p> <p>Ne takimin informues me Rektoren, përgjegjës të DTI dhe përgjegjës të zyrave perkatëse, GVJ konkludon se komunikimi jashtë dhe brenda institucionit bëhet në bazë të Politikës së Komunikimit [Evidence 24 – Politika e Komunikimit] si dhe Politikës së Përdorimit të Internetit, Postës Elektronike dhe Infrastrukturës IT [Evidence 37 – Politika e Internetit]; [(<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/">https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/</a>).</p> <p>Pranë KPT funksionon Zyra e Karrierës, Mbeshtetjes dhe Informimit, [Evidence 3 – Statuti, neni 15, pika (4)], e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KPT dhe</p>

	<p>programet e studimit që ofron si dhe orienton të interesuarit te zyrat përkatëse), Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik. Kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Statut [Evidence 3 – Statuti] dhe në Rregulloren KPT [Evidence 4 – Rregullorja KPT].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit dhe vendos në dispozicion studentëve, kriteret e procedurat e njohjeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit;</li> <li>• Kontratës që nënshkruhet me KPT në momentin e regjistrimit</li> <li>• Kontakteve me Zyrën e Informacionit të Studentit;</li> </ul> <p>[Evidence 5- Rregullore mësimore të programit të studimit (neni 12)].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të mësimit, në fillim të vitit akademik, studentët njihen me rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve, ku ndër të tjera janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve, sipas Rregullores KPT / rregulloren mësimore të programit të studimit si dhe në syllabus-in e çdo lëndë, syllabus i cili vihet në dispozicion të studentëve [Evidence 5.5 Syllabuset].</p> <p>Gjithashtu vlerësimi, i shprehur në notë dhe gërmë, përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e KPT [Evidence 4 -Rregullorja e KPT, Kreu V, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes] e ne vijim), ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe vecanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe student duhet të ndjekin.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga studimi i DVV, GVJ kostaton se KPT ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe vecanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe student duhet të ndjekin.</p> <p>Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitroimi dhe sekretimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i</p>

	<p>studentëve.</p> <p>Në rregulloren e institucionet dhe bazën ligjore të institucionit janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, sipas vendimit të Rektorit për çdo vit akademik, [Evidence 4 -Rregullorja e KPT, Neni 56 Mbrojtja e diplomës].</p> <p>Formati i diplomës së programit është i miratuar përkatësisht nga QSHA [Evidence 40 Miratimi i modelit të Diplomës].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, KPT organizon dhe ndërmerr:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• aktivitete dhe evente të ndryshme në përputhje dhe me udhëzimet e strukturave përgjegjës për arsimin;</li> <li>• vizita në ambientet e KPT për të parë dhe njohur nga afër me institucionin ku ftohen të marrin pjesë maturanatë, mësues dhe prindër [Evidence 24/2 Open days në KPT],</li> </ul> <p>KPT është rregullisht pjesëmarrës në panairt e organizuar nga Dhoma e Tregtisë, në panairt të organizuara nga organizata dhe institucione të ndryshme ku promovohet IAL dhe arrijtet në fushën e ndërkombëtarizimit etj që luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e programeve të studimit, në organizimin e tureve nëpër gjimnaze / shkolla të mesme sipas udhëzimeve përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin [Evidence 24.1 Turet], ku shpërndan broshura dhe fletëpalosje informuese të cilat pajisen dhe QR Code, i cili duke u skanuar të drejton në faqet zyrtare të KPT, mban dhe përditëson rrjetet sociale në mënyrë të vazhdueshme duke e furnizuar me informacion sa më të saktë dhe të plotë, [Evidence 30 Java e Orientimit], si dhe i vë në dispozicion Studentit një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT [Evidence 27 Manuali i Studentit].</p> <p>Studentët janë pajisur me Kartën e Studentit [Evidenca 43 Karta e Studentit]; [Evidence 24 Politika e Komunikimit].</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen gjatë javës orientuese dhe në seancat e para të leksioneve me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik, me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit dhe informacione të tjera të</i></p>

*Kulloran*




	<i>rëndësishme për mbarëvatjen e studimeve të tyre.</i> <i>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatoren e programit të studimit dhe përgjegjësën e grupit të tyre mësimor mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nepermjet faqes zyrtare te KPT e cila përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, silabusët për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat janë përditësuar ne kete faqe [Evidence 37/1 - Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit] (Evidence 37/2 screeshot i faqes së internetit KPT).</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimi me Rektorin, Pergjegjesin e Departamentit dhe drejtuesit e zyrave perkatese, GVJ evidenton se per cdo vit kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit jane shqyrtuar dhe miratuar nga Senati Akademik [Evidence 23 – Vendimet SA], jane dërguar pranë organeve përkatëse, vendosur në portalin U Albania si dhe jane publikuar e përditësuar në faqen e internetit të KPT (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/">https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/</a>)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë	Nga takimi i GVJ me studentet dhe shqyrtimi i DVV, mesuam praktiken e ndjekur ne KPT ku studentet jane njohur me informacionin kryesor në lidhje me jetën studentore nëpërmjet “Manualit të Studentit” [Evidence 27 - Manuali i Studentit]] dhe Sistemit Clusster [Evidence 28/1 - Sistemi i Institucionit/Classter].

formuese.	<p>Faqja zyrtare <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/">https://kolegjiprofesional.edu.al/</a> përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, silabusët për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, Statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte</p> <p>[Evidence 37/1 - Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit].</p> <p>Në faqen e internetit publikohet dhe përditësohet informacion i plotë, i saktë dhe i detajuar në lidhje me portofolin dhe ofertën akademike të KPT (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit/">https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit/</a> duke vënë theksin te aftësimi, kompetencat dhe mundësitë e punësimit. Për çdo lëndë, studentit i vihen në dispozicion Syllabus i Lëndës [Evidence 5.5 -Syllabus] si dhe organizohen Tutoriate [Evidence 17 – Tutoriatet këshillim akademik].</p>																					
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Statuti i KPT, neni 15 (2), ngarkon Zyren e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve e cila në bashkëpunim me DTI, mban një database me të dhënat e çdo studentit të diplomuar në lidhje me punësimin e karrierën e tij dhe mban statistikën përkatëse [Evidence 12 Sondazhi Alumni].</p> <p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike</p> <p>Studentët shkojnë drejt përballjes me tregun e punës që në stadin e zhvillimit të praktikave profesionale, të cilat sigurohen nga vetë KPT [Evidenca 33 – Lista e Partnerëve, marrëveshje]. KPT është në kontakt të vazhdueshëm me biznese apo industri të ndryshme, në lidhje me mundësitë e punësimit që disponojnë për t’ia ofruar më pas studentëve të diplomuar të KPT</p> <p>Punesimi i studenteve te punesuar ne vite ne KPT</p> <table border="1" data-bbox="651 1697 1394 1906"> <thead> <tr> <th colspan="7">VITET</th> </tr> <tr> <th>2017</th> <th>2018</th> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2022</th> <th>2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>80 %</td> <td>90%</td> <td>90%</td> <td>100%</td> <td>100%</td> <td>90%</td> <td>Ne proces azhornimi</td> </tr> </tbody> </table>	VITET							2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	80 %	90%	90%	100%	100%	90%	Ne proces azhornimi
VITET																						
2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023																
80 %	90%	90%	100%	100%	90%	Ne proces azhornimi																

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentet mesuam se ata kishin informacion te plote mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, kriteret e procedurat e njohjeve. Ky informacion merrej nëpërmjet këshillimit me stafin akademik, kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit, Rregullores KPT / rregullores mësimore të programit të studimit (neni 12), kontratës që nënshkruhet me KPT në momentin e regjistrimit dhe ne javës e Orientimit.</p> <p>Me pas koordinatorja e departamentit mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike dhe me telefon me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete te ndryshme, informacione që lidhen me oraret etj.</p> <p>Çdo informacion tjetër ne lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në KPT, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit Classter /Teams</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>KPT ka ndërtuar ura bashkëpunimi me organizatat e bizneseve si Dhoma e Tregtisë Tiranë, vendase apo të huaja etj [Evidence 33 - Lista e Partnerëve Marrëveshjeve me subjektet pritëse – Marrëveshjet], bashkëpunon me emra të njohur të biznesit e industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura, ku realizohet praktikë aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi, të cilat ju bëhen me dije studentëve nëpërmjet komunikimeve me email, njoftimeve etj.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet dhe orienton përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.4**



**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita ne strukturat e KPT, GVJ konstaton se Institucioni disponon statistika të plota mbi ecurinë e studentëve. Zyra e Protokollit dhe Arkivës, Sekretaria Mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore e Kontratave dhe Zyra e Financës, Zyra IT dhe Projekteve, ruajne dokumentacionin për të gjitha veprimtaritë e rëndësishme të institucionit përkatësisht sipas fushës së veprimtarisë [Evidence 3 – Statuti] dhe qëndrimi i dokumentacionit në letër bëhet nga Zyra e Protokollit dhe Arkivës.</p> <p>Zyra e Protokollit dhe Arkivës në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore, dhe Zyrën e Financës është përgjegjëse për nxjerrjen e statistikave, raporteve vjetore, sipas nevojave të institucionit, kërkesave të autoriteteve përgjegjëse për arsimin etj.</p> <p>Kolegji mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matricullimit për çdo program studimi ne Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave nëpërmjet Sistemit Classter [Evidence 28/1 Sistemi i Informacionit / Classter] dosjes së studentit dhe regjistrin themeltar. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar (regjistri bazë) [Evidence 45 Regjistri baze] i cili përmban të dhënat e detajuara për programin e studimit, formën e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve (vlerësimet e marra nga studenti) gjatë gjithë ciklit të studimit që nga regjistrimi. Të dhënat mbahen dhe përditësohen elektronikisht në sistemin Classter, si dhe në kopje fizike në regjistrat e notave [Evidence 45/1 - Regjistri i arritjeve akademike] që mbahet në Sekretarinë Mësimore [Evidence 3 – Statuti] si dhe të dhënat për diplomimet [Evidence 45/2 Regjistri i diplomave] të cilat mbahen nga koordinatoret.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të</p>	<p>Në formë elektronike të dhënat e studentëve menaxhohen në Sistemin Classter [Evidence 28/1 - "Sistemi i Institucionit/Classter].</p> <p>Zyra e Financës përdor sisteme të veçanta që lidhen me kontabilitetin në përputhje me parashikimet ligjore, dhe mundëson gjenerimin e raporteve</p>

<p>informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>sipas nevojave.</p> <p>Informacioni garanton siguri në nivelet e tij.</p> <p>Të dhënat në bazë të kërkesave ligjore, mbahen në regjistra fizike administrohen nga zyrat përkatëse sipas kompetencave, firmosen nga personat përgjegjës dhe mbahen në vende të sigurta (të mbyllura).</p> <p>Tabea e studenteve te programit te studimit TIE</p> <table border="1" data-bbox="651 427 1393 790"> <thead> <tr> <th>Sipas viteve akademike</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Të larguar</th> <th>Ndërprerë studimet</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>9</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>14</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>17</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>19</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td colspan="4" style="text-align: center;">59</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Sipas viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të larguar	Ndërprerë studimet	Totali	2020-2021	9	-	-	-	9	2021-2022	14	-	-	-	14	2022-2023	17				17	2023-2024	19	-	-	-	19	Total	59				
Sipas viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të larguar	Ndërprerë studimet	Totali																																
2020-2021	9	-	-	-	9																																
2021-2022	14	-	-	-	14																																
2022-2023	17				17																																
2023-2024	19	-	-	-	19																																
Total	59																																				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës është akredituar për herë të parë si institucion i arsimit të lartë me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 66, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Tiranës” dhe është riakredituar në vitin 2023. Programi i studimit u akreditua nga ASCAL dhe aktualisht është në procesin e akreditimit të dytë të këtij programi.</p> <p>KPT kontrollon periodikisht sekretarinë mësimore, si njësi përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve mbi saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët.</p> <p>Dokumentacioni ruhet në format fizik dhe elektronik sipas rregullave në fuqi.</p> <p>KPT përfshin dhe ekspertë të jashtëm në vlerësim të aspekteve të ndryshme të aktivitetit të tij, si për shembull në kurrikula / programe studimi etj</p>																																				
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të</p>	<p>Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe mbi cilësinë e punësimit të tyre duke i shoqëruar me masat e duhura në drejtim të rishikimit, vlerësimit periodik dhe ërmirësimit të kurrikulës.</p> <p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, si njësi bazë për programin, në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Sekretarinë Mësimore, vlerësojnë cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për çdo program studimi [Evidence 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve].</p>																																				





këtyre treguesve.				
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni disponon Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim.</i></p> <p><i>Zyra e Protokollit dhe Arkivës, Sekretaria Mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore e Kontratave dhe Zyra e Financës, Zyra e IT dhe Projekteve, ruajnë dokumentacionin për të gjitha veprimtaritë e rëndësishme të institucionit përkatësisht sipas fushës së veprimtarisë dhe qendërimi i dokumentacionit në letër bëhet nga Zyra e Protokollit dhe Arkivës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	KPT inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrjen e organeve drejtuese të tij, organizimin e lirë, dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre. [Evidence 2 Statuti KPT, Neni 46 - Këshilli i Studentëve]. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Njësinë e Sigurimit të cilësisë, Senatit akademik etj. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi. Përbërja e Këshillit të Studentëve publikohet në faqen e internetit të KPT ( <a href="https://kolegjiiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/">https://kolegjiiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/</a> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	Nga takimi me drejtuesit e KPT, zyrave perkatëse dhe vecanerisht nga të dhënat e grumbulluara nga takimi me studentet del qarte se Këshilli Studentor promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KPT, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Anëtarët e tij zgjidhen nga vetë studentët në një proces votimi të fshehtë.

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KPT merr mendimin e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimmarrëse ku Këshilli Studentor shpreh dhe propozon mendime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KPT.</p> <p>Në KPT studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim. Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët.</p> <p>Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>KPT në kuadër të mbarëvajtjes e cilësisë së programeve merr mendimin e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimmarrëse (si në Senat, NjSBC, Këshilli studentor) [Evidence 3 Statuti], përdor metoda vlerësimi si mbledhjet, fokus grupe, sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, ku krahas çështjeve të ndryshme, trajtohet sigurimi dhe përmirësimi afatgjatë i cilësisë së programeve të studimit [Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente, Evidencë 16 Fokus Grupe, Evidencë 17 Tutoriatet/këshillim akademik]; [Evidence 6.4 Anketa e Stafit] ; [Evidence Mbledhje e Asamblesë së Personelit].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Institucioni ndjek procedurat e parashikuara në rregullore për zgjidhjen e problematikës [Evidence 42 Formular kërkesë].</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar [Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit].</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se KPT, DTI, kane ndertuar ura bashkepunimi, ku përfshihen dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit,</i></p>



	<i>metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe Rregulloret e brendeshme.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Nga takimet ne istitucion me perfaqesues ne KLP, GVJ kostaton</p> <p>Se orientimi dhe këshillimit i studentëve është i ndarë në dy faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Orientimi dhe këshillimi për maturanët që duan të ndjekin studimet pranë KPT</i></li> <li>• <i>Orientimi dhe këshillimi për studentët gjatë kohës së tyre në KPT.</i></li> </ul> <p>Strukturat në funksion të këtij procesi janë kryesisht: Zyra e Karrierrës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve – për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore etj. dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Koordinatorët mësimore dhe varësisht natyrës së çështjes, edhe struktura dhe anëtare të stafit.</p> <p>Për Studentët e rinj, KPT organizon çdo vit, Javën e Orientimit të Studentëve, vë në dispozicion Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT, komunikimeve me email, publikimeve në faqen e internetit dhe rrjetet sociale.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje	<p>KPT ofron Tutoriatin gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët, në përputhje me rregulloren e Tutoriatit [Evidence 17/I Rregullorja Tutoriati si dhe <a href="https://kolegji profesional.edu.al/keshillimi-akademik-tutoriati/">https://kolegji profesional.edu.al/keshillimi-akademik-tutoriati/</a> ] ;</p>

*Handwritten signature and mark*

<p>që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>[Evidence 41 Emaillet njoftuese nga koordinatoret].</p> <p>Gjatë procesit dhe vitit akademik, KPT, për çështje të ndryshme që mund të kenë, i jep mundësi studentit të paraqesë kërkesë me shkrim [Evidence 42 Formular kërkesë], e cila sipas natyrës së kërkesës, i adresohet strukturave përkatëse në KPT.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik sipas kompetencat [Evidence 3 – Statuti] dhe në Rregulloren KPT (Evidence 4 – Rregullorja KPT).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>KPT, Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Koordinatorët mësimore dhe varësisht natyrës së çështjes edhe struktura dhe anëtare të stafit mbahen kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit.</p> <p>KPT është i pajisur me sinjalistikë në ambientet e përbashkëta dhe në zyra.</p> <p>Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve organizon, menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe çështje të tjera të lidhura me to, si dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve, për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për sa i përket karrierës</p> <p><a href="https://kolegijiprofesional.edu.al/keshillimi-akademik-tutoriati/">https://kolegijiprofesional.edu.al/keshillimi-akademik-tutoriati/</a></p> <p>KPT organizon panairë pune [Evidence 18.1 Panairi i Punës], trajnime me palë të treta (si Bashkia Tiranë, Zyra e Këshillimit të Karrierës etj), në lidhje me dosjen e karrierës, si përgatitjen e CV, letrës së motivimit etj, [Evidence 21 Trajnime student], si dhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së, ku KPT është pjesë (si praktika 1 dhe 3 mujore në Hungari, Poloni, Greqi etj.</p> <p>KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e KPT si</p>



	<i>ReMany (punësimi në Gjermani), Ujësjetës Kanalizime Tirana, Dhoma e Tregtisë në Austri, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve Kosovë etj.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	<p>KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit [Evidence 12 Sondazhi Alumni].</p> <p>Kjo Zyrë mban një database të saktë [Evidence 12.2 Punësimi i Studentëve] dhe mban e përpunon statistikën përkatëse [Evidence 18/1 Panairi i Punës].</p> <p>Seksioni KPT Alumni (<a href="http://kolegijiprofesional.edu.al/web/jeta-studentore/alumni/">http://kolegijiprofesional.edu.al/web/jeta-studentore/alumni/</a>) është pjesë e informimit mbi raportin vjetor të veprimtarisë së KPT.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Pranë KPT funksionojnë Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave si struktura përgjegjëse, që zhvillojnë dhe drejtojnë procesin e këshillimit të karrierës, ofrojnë asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mbajnë kontakte në formë të ndryshme me të diplomuarit dhe krijojnë Rrjetin Alumni.</i></p> <p><i>Nepermjet punës se tyre me ndihmesën për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës dhe përpunimin e këtij informacioni për autoritetet drejtuese përkatëse, Institucioni realizon plotësisht kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në këto standard.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji e Instalimeve Elektrike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. KPT zotëron infrastrukturë dhe ambientet më se të përshtatshme me pajisjet e duhura për këtë lloj arsimimi. Laboratorët, oficina dhe maketet e KPT përfaqësojnë zërin e fundit të teknologjisë të paisjeve të arsimit profesional.
2. Institucioni dëshmon raport të lartë të punësimit të studentëve, kontribuon në shpërndarjen dhe gjetjen e mundësive të punësimit, nëpërmjet panairëve të punës, punësimit gjatë praktikës profesionale dhe kontakteve direkte me biznesin.
3. Institucioni ka garantuar një mjedis pune të shëndetshëm që ofron mundësi të barabarta dhe jodiskriminuese për personelin akademik dhe administrativ, me politika të qarta të burimeve njerëzore, të cilat synojnë tërheqjen e një stafi sa më profesionist dhe të kualifikuar, duke synuar gjithmonë në një kombinim brezash dhe përvojash, dhe përzgjedhjen e ekspertëve më të mirë të fushës.
4. Institucioni ka vendosur ura të forta bashkëpunimi me biznesin dhe ofron mundësinë e praktikave profesionale dhe këshillimin në hartimin e programeve të studimit dhe kurrikulave.
5. Programi i studimit dhe kurrikulave të tij bashkëkohore, është tërësisht e orientuar dhe në përputhje me tregun e punës e kërkesat e tij, duke zgjeruar portofolin e projekteve pilot të mobilitetit në arsimin profesional të mbështetur nga BE. Praktika në laboratorë moderne, praktika profesionale e kombinuar edhe me vizita në terren janë elemente të spikatura të programit të studimit.

**Pika të dobta**

1. Institucioni të beje me shume per të permiresuar dhe detajuar informacionin në faqen e Web-it të institucionit për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, për të krijuar një frymë besimi ndaj diplomës profesionale që leshon. [Standardi II.3, kriteri 3]
2. Institucioni të beje me shume dhe të garantoje vazhdimësinë në KPT, duke rekrutuar stafit të ri me grada dhe tituj shkencore. [Standardi III.1, kriteri 4]

**Rekomandime**

1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit për arsimin e lartë profesional dhe ndjekja në vijimësi e adresimit të pozicionimit të diplomës profesionale në legjislacion me autoritetet përgjegjëse dhe nëpërmjet permiresimit dhe detajimit të informacionit në faqen e Web-it.
2. Institucioni të beje me shume përpjekje për garantimin e vazhdimësisë në KPT, duke rekrutuar stafit të ri me grada dhe tituj shkencore.



**Evaluation's conclusions for the professional study program " Technology of Electrical Installations " provided by the Higher Education Institution " Professional College of Tirana "**

**Strengths and affirmations**

1. KPT has more than adequate infrastructure and facilities with the right equipment for this type of education. KPT's laboratories, offices and mock-ups represent the latest in vocational education equipment technology.
2. The institution demonstrates a high rate of student employment, contributes to the distribution and finding of employment opportunities, through job fairs, employment during professional practice and direct contacts with business.
3. The institution has guaranteed a healthy working environment that offers equal and non-discriminatory opportunities for academic and administrative personnel, with clear human resources policies, which aim to attract the most professional and qualified staff, always aiming at a combination of generations and experiences, and the selection of the best experts in the field.
4. The institution has established strong cooperation bridges with business and offers the possibility of professional practices and counseling in the design of study programs and curricula.
5. The study program and its contemporary curricula are completely oriented and in accordance with the labor market and its requirements, expanding the portfolio of mobility pilot projects in professional education supported by the EU. Practice in modern laboratories, professional practice combined with field visits are prominent elements of the study program.

**Weaknesses**

1. The institution should do more to improve and detail the information on the institution's website about the general and specific criteria for acceptance, transfer and equivalence of studies, in order to create a spirit of confidence in the professional diploma it issues. [Standard II.3, criterion 3]
2. The institution to guarantee continuity in KPT, by recruiting new staff with degrees and scientific titles. [Standard III.1, criterion 4]

**Recommendation**

1. Increasing awareness and information about higher professional education and continuing to address the positioning of the professional diploma in legislation with the responsible authorities and through the improvement and detailing of the information on the website
2. The institution should make more efforts to guarantee continuity in KPT, by recruiting new staff with degrees and scientific titles



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

*Kamasa*  
